REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr.2300/2 Prot. Vlorë më, 22.10.2026

VENDIM

Nr29, datë 22 / 10 /2026

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË LLOGARIVE ZYRTARE NË RRJETET SOCIALE FACEBOOK DHE INSTAGRAM PËR QENDRËN KËRKIMORE SHKENCORE TË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE DHE BALLKANISTIKE

Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të nenit 15, pika 4, shkronja "a", të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e faqeve/mediave sociale për llogari të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe të vendimit të Rektoratit nr. 7, datë 09.09.2024, "Për hapjen e faqeve/mediave sociale për llogari të Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë", në mbledhjen e datës 12.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e llogarive zyrtare në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram për Qendrën Kërkimore Shkencore të Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike, në funksion të promovimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, njoftimit të aktiviteteve dhe publikimit të informacioneve që lidhen me veprimtarinë e Qendrës.
2. Administrimi i faqes/llogarisë së njësisë bazë të kryhet nga administratori i caktuar nga drejtuesi i njësisë bazë, në përputhje me nenin 16, pika 4, të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e faqeve/mediave sociale për llogari të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Publikimi dhe administrimi i përmbajtjes në këto llogari të kryhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", të ndryshuar
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra Kërkimore Shkencore e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike, në bashkëpunim me Sektorin e promovimit dhe marrëdhënieve me publikun.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof.Dr. Aurela Saliaj

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al